



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 4 Mars 2022

Nr: 121

V E N D I M
P Ë R

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË “FOKUS MEDIA GRUP” PËR VËZHIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE, TË DATËS 6 MARS 2022

Sot, më datë 4.3.2022, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën e:

KËRKUES: “FOKUS MEDIA GRUP”, me seli në Tiranë, me përfaqësues z. Ylli Rakipi

OBJEKTI: Kërkohet akreditimi si vëzhgues i gazetarëve për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimi nr. 2, datë 2.2.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore” dhe vendimi nr. 2, datë 22.1.2022, i Komisionit Rregullator “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”.

VËREJ:

“Fokus Media Grup” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 58 (pesëdhjetë e tetë) gazetarëve, si dhe zonat e



vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur nuk respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 9, të vendimit nr. 2/2022, të Komisionit Rregullator. “Fokus Media Grup” është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Kërkesa e paraqitur nuk është dorëzuar brenda afatit procedural të përcaktuar në pikën 11, të vendimit nr. 2/2022, të Komisionit Rregullator. Subjektet kërkuese gëzojnë të drejtën të caktojnë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor dhe përmbushin kushtin ligjor.

Afatet në procedurën administrative janë me rëndësi të veçantë për krijimin ose humbjen e ndonjë të drejte të palës. Afati i përcaktuar në pikën 11, të vendimit nr. 2/2022 të Komisionit Rregullator i cili përcakton se kërkesat e vëzhguesve shqiptarë për akreditim i paraqiten Komisionit Qendror të Zgjedhjeve jo më vonë se data 18 Shkurt 2022, paraqet një interval të caktuar kohor, brenda të cilit duhet të kryhet veprimi në procedurën administrative. Afati procedural i vendosur nga Komisioni Rregullator, në kuptim të nenit 53, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, nuk përbën afat të karakterit prekluziv, mosrespektimi i të cilit do të sillte humbjen e së drejtës subjektive të palës. Komisioni Rregullator në kuadër të zgjedhjeve të pjesshme, ka arsyetuar dhe vendosur një afat të logjikshëm për palët kërkuese nga njëra anë për realizimin e së drejtës së tyre të ligjshme për të pasur vëzhgues në zgjedhje, dhe nga ana tjetër, për vetë administratën e KQZ-së për të kryer veprimet procedurale përkatëse. Kërkesa e paraqitur për realizimin e së drejtës së palës kërkuese dhe mosrespektimi i afatit procedural, nuk sjell humbjen e të drejtën për të kryer veprimin procedural, të cilin është dashur t’u kryejë brenda afatit të caktuar.

Në çdo rast, vendosja e këtij afati procedural konsideron garantimin e sigurisë juridike dhe standardeve të rëndësishme për një proces të rregullt zgjedhor. Afatet në këtë rast nuk janë indikative, në kushtet kur implikojnë cënim të standardit zgjedhor. Pika 2, e nenit 6, të Kodit Zgjedhor parashikon se, organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, si dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe të medias kanë të drejtë të dërgojnë vëzhgues në zgjedhje. Në këtë kuptim, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve arrin në konkluzionin se afati i parashikuar në pikën 11, të vendimit nr. 2/2022 të Komisionit Rregullator nuk është afat prekluziv, që të përbente kusht për refuzimin e kërkesës dhe moszbatimin e afatit tërësor të akreditimit të vëzhguesve përpara datës së zgjedhjeve. Interpretimi ndryshe i kësaj dispozite, do t’i mohonte kërkuesit të drejtën për të caktuar vëzhgues.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimin nr. 2, datë 2.2.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore” dhe vendimin nr. 2, datë 22.1.2022, i Komisionit Rregullator “Për miratimin e disa afateve proceduriale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S I:

1. Akreditimin si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 58 (pesëdhjetë e tetë) gazetarëve të “Fokus Media Grup”, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

